




Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse / Privremena Institucija Samouprave / Provisional Institutions of Self Government
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Shërbimeve Publike / Ministarstvo javnih službi / Ministry of Public Services

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Llogaritë Kombëtare 2002-2004



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo

Parathënie

Gjatë periudhës tri vjeçare, (Mars 2003 deri në prill 2006), Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER) ka përkrahur Entin e Statistikave të Kosovës (ESK) duke financuar projektin për ndërtimin e kapaciteteve, projekt i realizuar nga Instituti ICON.

Në këtë përkrahje për ESK-në është përfshirë edhe zhvillimi i Llogarive kombëtare. Prandaj ESK tani është e gatshme të prezantojë Bruto Produktin Vendor (BPV) sipas metodës së shpenzimeve dhe sipas aktiviteteve. Po ashtu ka vlerësuar edhe normën e rritjes ekonomike sipas aktiviteteve me çmime konstante. Llogaritë kosovare janë përpiluar në bazë të rekomandimeve të Sistemit Evropian të Llogarive të vitit 1995 (ESA'95). Për të bërë këto vlerësime janë përdorë tabelat furnizuese përdoruese.

Është hera e parë që ESK publikon të dhënat për Llogaritë kombëtare dhe BPV. Është kërkesë e kahershme për këto të dhëna, veçmas për normën e rritjes së BPV, e cila përdoret për planifikim ekonomik të Qeverisë, donatorëve për të vlerësuar programet mbështetëse për sektorë të ndryshëm të ekonomisë, si dhe në zhvillimin e shtetit në përgjithësi. Rezultatet e llogarive kombëtare po ashtu përdoren edhe nga investitorët e jashtëm dhe të brendshëm për të vlerësuar situatën ekonomike të shtetit dhe mundësitë për investime të reja.

ESK do të vazhdojë zhvillimin e Llogarive kombëtare në pajtim me rekomandimet ndërkombëtare dhe do të publikojë të dhëna kualitative dhe me kohë.

Ky publikim është përgatitur nga Dr Anna Lennblad – Menaxhere e projektit të AER-it (Implementuar nga Instituti ICON) dhe Divizioni i Llogarive kombëtare në ESK : Xhevrie Fetahu, Bujar Uka, Shkelzen Ademi dhe Emine Bajrami, në bashkëpunim me Ilir T. Berisha - Drejtor i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare.

Komentet dhe sugjerimet e juaja janë të mirëseardhura në adresën economic@ks-gov.net

u.d. i Kryeshefit Ekzekutiv të ESK-së
Mr. sc. Ramiz Ulaj

Korrik, 2006

Seksioni i parë:

Llogaritë kombëtare paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe tërësore për të gjitha transaksionet që kanë ndodhur brenda një periudhe të caktuar, dhe në këtë mënyrë ato paraqesin një pamje të përgjithshme të ekonomisë kosovare. Ato ofrojnë një përshkrim sistematik, konsekuent dhe statistikor të ekonomisë në përgjithësi dhe të raportit reciprok ndërmjet sektorëve të ndryshëm ekonomik dhe ekonomisë së përgjithshme si dhe pjesës jo-rezidente.

Në Kontabilitetin (llogaritjet) kombëtar, shoqëria është e ndarë në sektorë dhe në llogari të aktiviteteve, të cilat formojnë një pjesë të sistemit të përgjithshëm të llogarive kombëtare. Vetë llogaritë në një mënyrë më të përmbledhur paraqesin një masë të madhe të informacioneve të hollësishme, të organizuar në bazë të parimeve dhe perceptimeve ekonomike lidhur me funksionimin e ekonomisë. Sidoqoftë, llogaritë e sektorëve nuk janë kompletuar ende; kështu që, ky prezantim përfshinë vetëm llogaritë e aktiviteteve. Veç kësaj, gjithashtu ai përfshinë edhe prezantimin e Bruto Prodhimit Vendor (BPV) sipas shpenzimit dhe shkallës së rritjes ekonomike sipas aktiviteteve me çmime konstante.

Llogaritë kombëtare kryejnë një funksion të dyfishtë:

Së pari, ato shërbejnë si mjet për të monitoruar zhvillimin e ekonomisë dhe të politikës ekonomike nëpërmjet vrojtimeve dhe analizave të bashkëveprimeve ekonomike që ndodhin ndërmjet sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Më saktësisht, të dhënat e përgjithshme të llogarive të ndryshme kombëtare, për shembull rritja e BPV-së, shfrytëzohen nga Qeveria për planifikim ekonomik, në implementimin e masave stimuluese. Ato shfrytëzohen nga donatorët për të vlerësuar efektet e programeve për asistencë në sektorët e ndryshëm të ekonomisë, si dhe zhvillimin ekonomik të vendit në tërësi. Natyrisht, donatorët janë veçmas të interesuar në BPV-në për kokë banori, të dhëna këto të cilat janë në dispozicion nga llogaritë kombëtare. Rezultatet nga llogaritë kombëtare gjithashtu shfrytëzohen nga investitorët e huaj dhe të vendit në vlerësimin e situatës ekonomike të vendit dhe të mundësive për investime të reja.

Së dyti, të dhënat dhe korniza themelore mund të shfrytëzohen në modelet ekonometrike, në çështjet buxhetore kombëtare, planifikimin makroekonomik, parashikimet dhe analizat teorike. Në këtë kontekst akademikët dhe institucionet qeveritare janë shfrytëzuesit kryesor të këtyre llogarive.

Tërësitë më të rëndësishme ekonomike që burojnë nga llogaritë kombëtare janë:

1. Bruto prodhimi vendor (BPV), paraqet masën e efekteve ekonomike të një vendi brenda një periudhe të caktuar kohore;
2. Bruto të ardhurat kombëtare (BAK), paraqesin masën e të ardhurave të fituara nga banorët rezident të një shteti brenda një periudhe të caktuar kohore;
3. Bruto të ardhurat kombëtare të disponueshme (BAKD), paraqesin masën e të ardhurave në dispozicion të banorëve rezident të një shteti për konsum dhe kursime brenda një periudhe të caktuar kohore;
4. Kursimet, paraqesin masën e fondeve në dispozicion pas konsumit për investim dhe huadhënie të banorët jo rezident;
5. Formimi i bruto kapitalit, është masë e shpenzimeve në mallra kapitale dhe objekte të fiksuara brenda një periudhe të caktuar kohore;
6. Neto huadhënia/huamarrja, masë e fondeve në dispozicion pas investimit për huadhënie/huamarrje tek/nga jo-rezidentet.

Enti i Statistikës së Kosovës (ESK) gjendet ende në fazën fillestare të përpilimit të llogarive kombëtare kosovare. Në këtë mënyrë, deri më tani, nga këto gjashtë tërësi të rëndësishme, ky publikim përfshinë vetëm vlerësimet për BPV-në nga aspekti i prodhimit dhe shpenzimeve si dhe formimin e bruto kapitalit.

Llogaritë kosovare janë përpiluar në bazë të Sistemit Evropian të Llogarive kombëtare të vitit 1995 (European System Accounts - ESA '95). Vlerësimet e tanishme të çmimeve janë nxjerrë nga tabelat furnizuese dhe përdoruese.

Seksioni i dytë: Korniza konceptuale

Definicioni i termeve

Konceptet e përgjithshme

Rezidenca

Në llogaritë kombëtare duhet të regjistrohen të gjitha transaksionet ku janë të përfshirë rezidentët. Prandaj, është e rëndësishme që të kemi një definicion të qartë të rezidencës. Definicioni i rezidencës është identik për tërë llogaritjen makroekonomike, si për statistikën monetare dhe financiare ashtu edhe për llogaritë qeveritare, llogaritë kombëtare dhe bilancin e pagesave.

Praktikisht, personat konsiderohen si banorë të një shteti nëse ata jetojnë për së paku një vit në atë shtet. Përjashtim në këtë rregull bëjnë personeli i ambasadave (me përjashtim të personelit vendor), pacientët që trajtohen jashtë shtetit dhe studentët që jetojnë jashtë shtetit, edhe atëherë kur qëndrimi i tyre ka tejkaluar një vit.

ESK-ja ka ndjekur këto udhëzime gjatë përmbledhjes së llogarive kombëtare për vitin 2002, 2003 dhe 2004. Megjithatë, Kosova nxjerrë në pah disa veçori të jashtëzakonshme për faktin se Kombet e Bashkuara po luajnë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm. UNMIK-u, një organ i Kombeve të Bashkuara, ka marrë shumë nga funksionet 'normale' të qeverisë. Në këtë kuptim, konsiderohet si rezident i Kosovës edhe pse ESA në mënyrë të qartë përcakton se organizatat ndërkombëtare duhet të konsiderohen si jo rezidente. Për të gjetur zgjidhje në këtë dykuptimësi, ESK-ja ka përpiluar dy grupe të vlerësimeve për BPV-në: njërin duke konsideruar UNMIK-un si rezident dhe tjetrin duke e konsideruar atë si jo rezident.

Vlerësimi

Prodhimi (Output) dhe vlera e shtuar duhet të vlerësohen në kohën kur artikujt e përdorimit të gjerë dalin nga procesi i prodhimit. Prodhimi dhe vlera e shtuar mund të maten në mënyra të ndryshme, varësisht nga cilat tatime dhe subvencionet në prodhim dhe në importe (që zakonisht referohen si tatime indirekte, një term i vjetër në ESA '95) janë të përfshira në këtë definicion. ESA '95 rekomandon vlerësimin e çmimeve bazë. Çmimi bazë është vlera e një malli apo një shërbimi të pranuar nga prodhuesi para aplikimit të ndonjë tatimi apo subvencionit përveç atyre të tatuara apo të pranuar para fillimit të procesit të prodhimit. Tatimet e tilla referohen si "tatimet tjera në prodhim" në ESA '95, dhe kryesisht përbëhen nga tatimet mbi shfrytëzimin e tokës dhe objekteve nga ndërmarrja, dhe lejeve të punës. Angazhimi i qeverisë për themelimin e një institucioni më qëllim të pakësimit të ndotjes, pavarësisht nga sasia e prodhimit, do të jetë një shembull i subvencionit të pranuar para fillimit të procesit të prodhimit.

Çmimi i prodhuesit është çmimi bazë plus tatimet dhe subvencionet tjera në prodhim dhe importe (përveç tatimeve mbi vlerën e shtuar); këto tatime referohen si tatime dhe subvencione në produkte. Shembujt më të rëndësishëm të këtyre tatimeve janë tatimet në shitje, akciza dhe tatimet e importit. Subvencionet marrin shumë forma të ndryshme, nga të cilat më të zakonshmet janë subvencionet në eksport dhe import.

Prodhimi (Outputi)

Prodhimi (Outputi) vlerësohet brenda një periudhe të caktuar kohore si vlerë e shërbimeve dhe mallrave të prodhuara nga ndërmarrjet rezidente. Outputi mund t'iu ofrohet njësisë tjera ose mund të shfrytëzohet për vetë konsum apo për përfitimin e bruto kapitalit fiks vetanak.

Outputi përbëhet nga dy kategori: artikujt e konsumit të gjerë dhe punës në progres. Vlera e shumicës së artikujve të konsumit të gjerë regjistrohet vetëm atëherë kur procesi i prodhimit të këtë përfunduar. Sidoqoftë, prodhimi i produkteve të caktuara mund të vazhdojë edhe pas përfundimit të periudhës llogaritëse. Në këtë rast puna në progres vlerësohet dhe regjistrohet. Puna në progres është posaçërisht relevante në ndërtimtari dhe bujqësi.

Outputi mund të karakterizohet ose si:

- **Output i tregut:** Outputi i tregut regjistrohet për mallra dhe shërbime, të cilat janë shitur me çmime të cilat ekonomikisht janë të vlefshme. Shumica e mallrave dhe shërbimeve të shitura në depo apo në dyqane tjera me pakicë përfshihen në këtë kategori; ose
- **Prodhimi vetanak:** Mallrat dhe shërbimet të cilat konsumohen brenda të njëjtës njësi të prodhimit konsiderohen si prodhim vetanak. Produktet bujqësore të konsumuara në fermën ku janë prodhuar janë shembuj të kësaj kategorie të prodhimit, ose
- **Outputet tjera jashtë tregut:** Outputet tjera jashtë tregut përbëhen nga mallrat dhe shërbimet e prodhuara nga qeveria, ose institucionet jo fitimprurëse, të ofruara pa pagesë apo me çmim që nuk është ekonomikisht i vlefshëm, për shembull shërbimet e arsimit të ofruara nga qeveria. Outputi tjetër jashtë tregut është kalkuluar si kosto e prodhimit, që do të thotë konsumi i ndërmjetëm, plus kompensimi i punëtorëve, plus konsumi i kapitalit fiks.

Konsumi i ndërmjetëm

Konsumi i ndërmjetëm është vlera e përgjithshme e mjeteve të shfrytëzuara, konsumuara apo të transformuara gjatë procesit të prodhimit. Ngjashëm me outputin, ai vlerësohet brenda një periudhe të caktuar kohore. Siç është përmendur më lartë, konsumi i ndërmjetëm vlerësohet sipas çmimeve të blerjes, të përcaktuar si çmim i prodhuesit, plus pagesat për transport, plus marzha e tregtisë me shumicë dhe pakicë.

Vlera e shtuar

Vlera e shtuar është një koncept thelbësor ekonomik i prodhimit që i referohet vlerës së prodhuar nga njësia e angazhuar në veprimtari prodhuese. Bruto vlera e shtuar definohet si output i përgjithshëm (i vlerësuar sipas çmimeve bazë), minus konsumi i ndërmjetëm, dhe neto vlera e shtuar sikurse bruto vlera e shtuar minus konsumi i kapitalit fiks. Neto vlera e shtuar pasqyron më mirë nivelin e veprimtarisë prodhuese; por sidoqoftë, për shkak të vështirësisë së matjes së saktë të konsumit të kapitalit fiks, bruto vlera e shtuar si koncept përdoret më shpesh se sa koncepti neto vlera e shtuar.

Vlera e shtuar llogaritet veçmas për secilën veprimtari rezidente në ekonomi. Ajo ofron një vlerësim të rëndësishëm të veprimtarisë në nivel të përgjithshëm.

Bruto Prodhimi Vendor (BPV)

BPV-ja me çmimet bazë është shuma e vlerës së shtuar e të gjitha njësive rezidente prodhuese. Në këtë mënyrë, ai është një vlerësim i përgjithshëm i prodhimit që ndodhë brenda një periudhe të caktuar kohore. Ngjashëm me prodhimin, vlerësimi i BPV-së mund të ndryshojë varësisht se cilat tatime në prodhim dhe importe janë përfshirë. Kur tatimet në produkte i shtohen shumës totale të vlerës së shtuar, atëherë BPV-ja vlerësohet sipas çmimit të tregut. Duke lënë anash tatimin mbi vlerën e shtuar në këtë vlerësim, fitohet BPV-ja sipas çmimeve të prodhuese.

Vlen të ceket se BPV-ja bën vlerësimin e prodhimit nga njësitë rezidente, pavarësisht nga lokacioni i veprimtarisë prodhuese. Për shembull, nëse një kompani kosovare e ndërtimeve merr punë jashtë Kosovës, vlera e ndërtimit nga kompanitë rezidente të ndërtimit duhet të përfshihet në vlerën e BPV-së kosovare.

Ekzistojnë tri mënyra të vlerësimit të BPV-së: BPV sipas prodhimit, shpenzimeve dhe të ardhurave. Sidoqoftë, ESK-ja ende nuk e ka bërë vlerësimin e BPV-së sipas të ardhurave.

Sipas prodhimit, BPV-ja është e barabartë me totalin e bruto vlerës së shtuar për të gjitha veprimtaritë ekonomike.

Pasi që ana furnizuese e të gjitha komponentëve mbi vlerën e shtuar për të gjitha mallrat dhe shërbimet duhet të jetë e barabartë me shpenzimet e përgjithshme në produktet e njëjta, atëherë duhet të merren parasysh karakteristikat e mëposhtme:

Sipas shpenzimeve, BPV-ja me çmimin e tregut = konsumi përfundimtar (final) + formimi i bruto kapitalit fiks + ndryshimet në inventarë + eksporti (i mallrave dhe shërbimeve) - importi (i mallrave dhe shërbimeve). Më fjalë tjera, BPV-ja sipas prodhimit është i barabartë me BPV-në sipas shpenzimeve.

Sipas një logjike të ngjashme, të ardhurat janë përafërsisht të lidhura me procesin e prodhimit; vlera e shtuar totale shfrytëzohet për të kompensuar faktorët e prodhimit, kapitalin dhe punën. Të ardhurat e paguara nga njësitë prodhuese tek kapitali konsiderohen si tepricë afariste. Të ardhurat e paguara për punën janë kompensim i të punësuarve. Për të fituar vlerën e tregut, tatimet në prodhim dhe importe pa subvencione, gjithashtu paguhën nga njësitë prodhuese. Prandaj, edhe karakteristikat e mëposhtme janë të vërteta

Sipas të ardhurave, BPV-ja me çmimet e tregut = kompensimi për të punësuarit (paguar nga prodhuesit rezident tek ekonomitë familjare rezidente dhe jo rezidente) + teprica (paguar nga ndërmarrjet, të cilat, sipas definicionit, janë rezidente, tek vetë ato ndërmarrje) + tatimet te zvogëluara për subvencione në prodhim dhe import. Me fjalë tjera, BPV-ja sipas prodhimit është i barabartë me BPV-në sipas të ardhurave.

Kategoritë e përdorimit përfundimtar (final)

Konsumi përfundimtar (final)

Për llogaritë kombëtare konsumi përfundimtar (final) regjistrohet nga Ekonomitë familjare, institucionet qeveritare dhe jo fitimprurëse. Ndërmarrjet nuk konsumojnë në këtë kuptim; siç është përmendur më lartë, produktet e shfrytëzuara gjatë procesit të prodhimit konsiderohen si konsum i ndërmjetëm, e jo konsum përfundimtar (final).

Konsumi përfundimtar (final) i ekonomisë familjare: Ky transaksion është regjistruar sipas çmimeve blerëse dhe përbën shpenzimet e ekonomisë familjare për të gjitha mallrat dhe shërbimet, me përjashtim të shpenzimeve për banim, të cilat konsiderohen si formim i bruto kapitalit fiks të pronarit. (Sidoqoftë, qiratë e objekteve dhe banesave klasifikohen si konsum përfundimtar (final) i shpenzuar nga ekonomia familjare).

Konsumi përfundimtar (final) nga institucionet qeveritare dhe jo fitimprurëse: Këto transaksione trajtohen në të njëjtën mënyrë në ESA '95.

Shpenzimet e bëra nga dy sektorët e fundit mund të ndahen në dy kategori: individuale dhe kolektive. E para përbën shpenzimet e bëra për përfitime individuale, psh. shërbimet

mjekësore. Shpenzimet kolektive kanë karakter publik, për shembull shpenzimet qeveritare në mbrojtën dhe sigurinë publike do të përfshiheshin në këtë kategori.

Formimi i bruto kapitalit:

Kjo tërësi paraqitet në llogaritë kapitale të llogarive kombëtare dhe në raportin mbi veprimtaritë qeveritare. Është njëra nga dy transaksionet kryesore në pasuritë (asetet) kapitale – tjetra quhet marrja/posedimi i pasurisë (aseteve) jo-prodhuese, jo financiare dhe është shqyrtuar më poshtë. Siç nënkuptohet nga emri, në formimin e bruto kapitalit fiks paraqiten të gjitha marrjet dhe posedimi i pasurive (aseteve) fikse, që do të thotë se të gjitha pasuritë (asetet) e prodhuara, janë të natyrës jo financiare dhe janë të transferueshme ndërmjet njësive prodhuese. Pasuritë (asetet) kapitale mund të jenë të prekshme – psh. ndërtesat, objektet, makineria – ose jo të prekshme – psh. softuerët kompjuterik. Ngjashëm me konsumin, ky transaksion vlerësohet sipas çmimit blerës.

Gjithmonë ekziston një paqartësi ndërmjet mallrave të qëndrueshme dhe pasurive (aseteve) fikse. Pasuritë (asetet) fikse janë ato të cilat vazhdimisht mund të shfrytëzohen në prodhim për më shumë se një vit. Siç nënkuptohet nga emri, mallrat e qëndrueshme nuk prishen ose prishen shumë ngadalë. Shembuj të mallrave të qëndrueshëm janë thëngjilli, nafta dhe armatura, sepse ato qëndrojnë për një periudhë të gjatë kohore. Sidoqoftë, këto mallra të qëndrueshme mund të shfrytëzohen si të hyra në prodhim vetëm njëherë – prandaj ato nuk janë pasuri (asete) fikse.

Gjithashtu ekzistojnë edhe shumë mallra afatgjate që mund të shfrytëzohen vazhdimisht në prodhim, për shembull makinat, prandaj ekziston një mundësi e madhe zëvendësimi ndërmjet mallrave afatgjate dhe asetëve fikse.

Megjithatë, ndryshimi ndërmjet mallrave afatgjate dhe pasurive (aseteve) fikse është jashtëzakonisht i madh. Kjo ndodhë për shkak se shpenzimi i pasurive (aseteve) fikse gjithmonë është shpenzim kapital, ndërsa shpenzimi i mallrave të qëndrueshme të cilat nuk mund të përdoren në vazhdimësi – siç janë thëngjilli dhe nafta – duhet të konsiderohen si konsum i ndërmjetëm.

Formimi bruto kapitalit definohet si shuma e formimit të bruto kapitalit fiks, ndryshimeve në inventar dhe neto marrjet e gjërave me vlerë. (Gjithashtu konsiderohet si investim, por për shkak se nuk ka ndonjë definicion të qartë për investimin, ky term nuk përdoret në këtë shqyrtim).

Të ardhurat kombëtare bruto (TKB)¹

Kjo variabël pasqyron vlerën e të ardhurave primare të fituara nga banorët brenda një periudhe të caktuar kohore. Të ardhurat primare definojnë si të ardhura që rrjedhin si rezultat i pjesëmarrjes në procesin e prodhimit apo nëpërmjet pronësisë së asetëve financiare dhe asetëve të prekshme, asetëve të pa prodhuara, më saktësisht toka dhe asetet tokësore

Qëllimi dhe përmbajtja e llogarive kombëtare

Përkufizimi i prodhimit

Në llogari kombëtare duhet të regjistrohen të gjitha zhvillimet ekonomike që kanë të bëjnë me rezidentët. Rrjedhat masin ndryshimet e pozicioneve të stoqeve gjatë një periudhe të

¹ Sipas Llogarive Kombëtare të vitit 1968 kjo është konsideruar si Bruto Prodhim Kombëtar; në ESA '95 ky term konsiderohet i vjetruar.

caktuar kohore. Siç është përmendur më lartë, në llogarinë e parë regjistrohen vetëm transaksionet, por edhe llogari të veçanta janë përpunuar për rrjedhat e mbetura. Për qëllime të analizave ekonomike, transaksionet më të rëndësishme janë padyshim ato prodhuese. Sidoqoftë, ekzistojnë shumë transaksione prodhuese ndërmjet agjentëve ekonomik të cilat nuk janë regjistruar në llogari kombëtare. Për shembull, një anëtar i një ekonomie familjare që prodhon djathë nga qumështi, pastron pjatat apo sjellë ujë, ka kryer një kontribut në prodhim; por jo të gjitha këto veprimtari janë përfshirë në llogaritë kombëtare. Më qëllim që të përcaktohet qartazi se çka duhet dhe çka nuk duhet të përfshihet, janë themeluar një varg rregullash dhe është përcaktuar një përkufizim prodhimi. Të gjitha transaksionet brenda këtij përkufizimi të prodhimit duhet të regjistrohen në mënyrë ideale si prodhim dhe të gjitha transaksionet jashtë këtij përkufizimi nuk duhet të përfshihen edhe nëse ato ekonomikisht janë kuptimplotë dhe në mënyrë të konsiderueshme kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të një vendi.

Shitjet njësisive tjera ekonomike: Brenda linjës së prodhimit, i gjithë prodhimi i prodhuar më qëllim të shitjes tek ndonjë faktor ekonomik i veçantë përfshihet pa përjashtim, pa marrë parasysh prodhuesin.

Prodhimi për vetë konsum të sektorëve prodhues: Prodhimi i prodhuar nga cilido nga katër sektorët prodhues, korporatat financiare, korporatat jo-financiare, qeveria dhe institucionet jofitimprurëse në shërbim të ekonomive familjare, të parapara për vetë konsum nuk bënë pjesë në linjën e prodhimit, më përjashtim të mallrave kapitale.

Prodhimi vetanak i ekonomive shtëpiake: Mallrat e prodhuara nga ekonomitë shtëpiake për konsum, megjithatë i përkasin linjës së prodhimit. Për shembull, ekonomitë familjare që prodhojnë ushqimin e vetë konsiderohen si veprimtari prodhues në kuptim të llogarive kombëtare, dhe vlera e ushqimit të prodhuar do të kontribuojë në BPV-në. Edhe më e rëndësishme është kur ekonomitë familjare ndërtojnë apo bëjnë përmirësime në shtëpitë e tyre, kjo është përfshirë në prodhim. Në anën tjetër shërbimet nuk janë përfshirë. Përjashtim të veçantë në këtë rregull bëjnë shërbimet e qirasë. Kur ekonomitë familjare janë pronarë të banesave të tyre, atëherë vlera i ngarkohet koston së qirasë, dhe kjo vlerë përfshihet në prodhim në anën e pjesës së furnizuese dhe konsumi final në anën përdoruese.

Tabelat furnizuese përdoruese

Tabelat furnizuese përdoruese janë krijuar për të nxjerrë vlera më të sigurt për BPV-në, se sa ato të fituara nga llogaritja e BPV-së (pa përdorimin e tabelave furnizuese përdoruese), nga aspekti i prodhimit dhe shpenzimeve veç e veç. Në tabelat furnizuese përdoruese, shifrat nga burimet e ndryshme paraqiten në mënyrë sistematike dhe të organizuar, duke i lejuar përpiluesit që të eliminojnë mospërputhjet dhe të largojë numrat nga burimet e të dhënave jo të sigurt dhe t'i zëvendësojë ato me numra nga burimet më të sakta. Gjithashtu ato i japin përpiluesit një kornizë për të identifikuar dhe plotësuar mungesën e të dhënave. Përfitimet e shumanshme janë shtjelluar në mënyrë detale në paragrafin 9.11 në ESA 95.

Tabela furnizuese është një matricë, e cila përmban tri transaksione furnizuese, të cilat mund të zbërthehen sipas produktit, domethënë: a) prodhimi me çmimet bazë; b) importet c.i.f.² (në përputhje me vlerën e çmimit bazë); dhe c) tatimet në produkte. Këto tri transaksione paraqiten në tri kolona të veçanta, Zakonisht, kjo tabelë gjithashtu përmban edhe dy kolona të përshtatjeve: a) marzha tregtare dhe e transportit; dhe b) përshtatjet c.i.f./f.o.b.³. Vlerësimi i prodhimit dhe importeve duhet të bëhet me çmimet bazë, që nënkupton se as marzha tregtare dhe e transportit, por as tatimet në produkte nuk janë përfshirë ende. Megjithatë, marzhat e transportit në Kosovë nuk janë përfshirë ende. Sa i përket përshtatjeve c.i.f./f.o.b.,

² (c.i.f. – shkurtesë e shprehjes doganore që rrjedhë nga fjalët ("Cost, Insurance and Freight" d.m.th. – Kostoja, sigurimi dhe transporti)

³ (f.o.b. - shkurtesë e shprehjes doganore që rrjedhë nga fjalët ("Free on board" dmth – i lire ne anije)

kjo është thjeshtë, sepse çmimet e importeve nga Doganat vlerësohen me c.i.f. (vlerësimi i rekomanduar për tabelën furnizuese përdoruese). Në këtë mënyrë, nuk është bërë ndonjë përshtatje në importin e mallrave. Sa i përket, importit të shërbimeve, janë bërë përshtatje poshtë kolonës së transportit dhe sigurimit. Shpjegimi teorik për përshtatjet e c.i.f./f.o.b. është dhënë me poshtë.

Tabela përdoruese gjithashtu është një matricë, dhe përshinë të gjitha transaksionet që kanë një kuptim domethënës të produkteve, domethënë: konsumin e ndërmjetëm, konsumin final, formimin e bruto kapitalit dhe eksportet. Këto transaksione vlerësohen me çmimin blerës që do të thotë se vlerësimi përfshin tatimin në prodhim dhe importe, si dhe marzhat e tregtisë dhe transportit për çdo grup individual të shifrave.

Në anën furnizuese- përdoruese, të tri transaksionet në anën furnizuese balancohen me katër transaksione në anën përdoruese. Kjo bëhet në një nivel detal të prodhimit. Për shembull, vlera e përgjithshme e pjesëve rezervë në anën furnizuese – dmth. pjesët rezervë të prodhuara brenda vendit dhe të importuara – balancohen me vlerën e përgjithshme në anën përdoruese të të njëjtit mall, dmth. konsumi nga njësitë prodhuese (konsumi i ndërmjetëm), konsumi nga ekonomitë familjare (konsumi final), konsumi nga jorzidentët (eksportet) dhe ndryshimet në inventarë. Për mallrat kapitale, gjithashtu ekziston formimi i bruto kapitalit fiks dhe neto marrja e pasurive (aseteve) kapitale nga njësitë prodhuese.

Po ashtu me transaksionet që mund të zbërthehen sipas produktit, tabela përdoruese gjithashtu përfshinë transaksionet që paraqiten në formë të krijimit të të ardhurave. Në këtë mënyrë, për ta balancuar në mënyrë detale anën furnizuese me atë përdoruese, vlera e shtuar me çmimet e tregut shpërndahet tek faktorët e prodhimit duke i shtuar tatimet në prodhim dhe importe. Kjo bëhet në një nivel detal të aktivitetit. Kjo është e rëndësishme sepse gjatë tërë ushtrimit të balancimit, duhet të verifikohet se shpërndarja ndërmjet tepricës dhe kompensimit të punëtorëve është e arsyeshme për çdo aktivitet.

Pasi që vlerësimi i transaksioneve në të dy tabelat është i ndryshëm, krahasimi i të dhënave sipas produkteve në tabelat furnizuese dhe përdoruese nuk është kuptimplotë pa përshtatje të mëtejme. Sipas marrëveshjes, këto përshtatje bëhen në tabelat furnizuese në formë të kolonave të quajtura marzhat e tregtisë dhe transportit dhe përshtatjet e c.i.f. / f.o.b. Marrëveshja gjithashtu dikton se përshtatjet bëhen në atë mënyrë që vlera e përgjithshme e të gjitha produkteve në tabelat furnizuese dhe ato përdoruese të jetë sipas çmimit blerës⁴. Kjo bëhet me qëllim që vlera e përgjithshme e çdo kategorie të produktit të jetë në përputhje në të dy tabelat.

⁴ Vlerësimi i transaksioneve duke përfshirë si marzhat e tregtisë dhe transportit, poashtu edhe tatimet në prodhim dhe importi i referohet çmimi i blerësit.

Shtojcë: Tabelat**Bruto produkti vendor në Kosovë sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale 2002****Tabela 1a (i): Duke konsideruar UNMIK-un si rezident dhe merr pjesë në BPV**

Aktivitetet ekonomike	Pjesëmarrja e BPV me çmimet prodhuese	Bruto vlera e shtuar	në milion Euro	
			Konsumi i ndërmjetëm	Output
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	100,0%	2.589,9		
Bruto produkti vendor me çmimet baze	84,7%	2.193,4		
AKTIVITETET GJITHSEJ	84,7%	2.193,4	1.233,5	3.426,9
Bujqësia dhe peshkimi	7,3%	188,0	57,0	245,0
Minierat, prodhimi, rryma elektrike dhe uji	13,9%	359,2	204,2	563,5
Sherbimet	63,6%	1.646,1	972,3	2.618,4
Ndërtimtaria	8,0%	208,0	308,9	516,8
Tregtia me shumicë dhe pakicë	7,8%	201,3	67,3	268,6
Hotelet dhe restorantet	2,4%	63,1	38,5	101,6
Transporti dhe komunikacioni	3,5%	90,6	33,7	124,3
Ndërmjetësimi financiar	2,3%	59,6	20,3	79,9
Pasuria e patundshme dhe shërbimet e biznesit	16,7%	431,3	9,7	441,0
Administrata publike dhe mbrojtja	20,9%	541,2	459,9	1.001,2
Qeveria E Kosovës	3,5%	90,5	269,7	360,3
UNMIK	17,4%	450,7	190,2	640,9
Arsimi	0,8%	19,4	11,5	31,0
Shëndetësia dhe punët sociale	1,0%	24,9	14,8	39,6
Shërbimet komunale, sociale dhe personale	0,3%	6,7	7,8	14,4
Plus: Tatimet mbi produktet	15,3%	396,6		

Tabela 1a (ii): Duke mos konsideruar UNMIK-un si rezident

Aktivitetet ekonomike	Pjesëmarrja e BPV me çmimet prodhuese	Bruto vlera e shtuar	në milion Euro	
			Konsumi i ndërmjetëm	Output
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	100,0%	2.139,2		
Bruto produkti vendor me çmimet baze	81,5%	1.742,7		
AKTIVITETET GJITHSEJ	81,5%	1.742,7	1.043,3	2.786,0
Bujqësia dhe peshkimi	7,3%	188,0	57,0	245,0
Minierat, prodhimi, rryma elektrike dhe uji	13,9%	359,2	204,2	563,5
Sherbimet	46,2%	1.195,4	782,1	1.977,5
Ndërtimtaria	8,0%	208,0	308,9	516,8
Tregtia me shumicë dhe pakicë	7,8%	201,3	67,3	268,6
Hotelet dhe restorantet	2,4%	63,1	38,5	101,6
Transporti dhe komunikacioni	3,5%	90,6	33,7	124,3
Ndërmjetësimi financiar	2,3%	59,6	20,3	79,9
Pasuria e patundshme dhe shërbimet e biznesit	16,7%	431,3	9,7	441,0
Administrata publike dhe mbrojtja	3,5%	90,5	269,7	360,3
Arsimi	0,8%	19,4	11,5	31,0
Shëndetësia dhe punët sociale	1,0%	24,9	14,8	39,6
Shërbimet komunale, sociale dhe personale	0,3%	6,7	7,8	14,4
Plus: Tatimet mbi produktet	18,5%	396,6		

Bruto produkti vendor në Kosovë sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale 2003

Tabela 1b (i): Duke konsideruar UNMIK-un si rezident dhe merr pjesë në BPV

Aktivitetet ekonomike	Pjesëmarrja e BPV me çmimet prodhuese	Bruto vlera e shtuar	në milion Euro	
			Konsumi i ndërmjetëm	Output
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	100,0%	2.505,0		
Bruto produkti vendor me çmimet baze	82,5%	2.066,9		
AKTIVITETET GJITHSEJ	82,5%	2.066,9	1.399,2	3.466,1
Bujqësia dhe peshkimi	7,5%	186,7	78,4	265,1
Minierat, prodhimi, rryma elektrike dhe uji	12,9%	322,9	258,6	581,4
Sherbimet	62,2%	1.557,4	1.062,2	2.619,6
Ndërtimtaria	8,8%	221,1	344,5	565,7
Tregtia me shumicë dhe pakicë	7,7%	193,4	84,8	278,1
Hotelet dhe restorantet	2,7%	67,1	48,7	115,8
Transporti dhe komunikacioni	3,4%	85,9	41,4	127,3
Ndërmjetësimi financiar	3,1%	77,7	34,4	112,1
Pasuria e patundshme dhe shërbimet e biznesit	16,1%	403,1	11,0	414,1
Administrata publike dhe mbrojtja	18,2%	455,2	460,0	915,2
Qeveria E Kosovës	4,3%	107,6	311,4	419,0
UNMIK	13,9%	347,6	148,6	496,2
Arsimi	0,8%	21,1	13,3	34,5
Shëndetësia dhe punët sociale	1,1%	26,3	15,1	41,4
Shërbimet komunale, sociale dhe personale	0,3%	6,4	9,0	15,4
Plus: Tatimet mbi produktet	17,5%	438,0		

Tabela 1b (ii): Duke mos konsideruar UNMIK-un si rezident

Aktivitetet ekonomike	Pjesëmarrja e BPV me çmimet prodhuese	Bruto vlera e shtuar	në milion Euro	
			Konsumi i ndërmjetëm	Output
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	100,0%	2.157,4		
Bruto produkti vendor me çmimet baze	79,7%	1.719,3		
AKTIVITETET GJITHSEJ	79,7%	1.719,3	1.250,6	2.969,9
Bujqësia dhe peshkimi	7,5%	186,7	78,4	265,1
Minierat, prodhimi, rryma elektrike dhe uji	12,9%	322,9	258,6	581,4
Sherbimet	48,3%	1.209,8	913,6	2.123,4
Ndërtimtaria	8,8%	221,1	344,5	565,7
Tregtia me shumicë dhe pakicë	7,7%	193,4	84,8	278,1
Hotelet dhe restorantet	2,7%	67,1	48,7	115,8
Transporti dhe komunikacioni	3,4%	85,9	41,4	127,3
Ndërmjetësimi financiar	3,1%	77,7	34,4	112,1
Pasuria e patundshme dhe shërbimet e biznesit	16,1%	403,1	11,0	414,1
Administrata publike dhe mbrojtja	4,3%	107,6	311,4	419,0
Arsimi	0,8%	21,1	13,3	34,5
Shëndetësia dhe punët sociale	1,1%	26,3	15,1	41,4
Shërbimet komunale, sociale dhe personale	0,3%	6,4	9,0	15,4
Plus: Tatimet mbi produktet	20,3%	438,0		

Bruto produkti vendor në Kosovë sipas aktiviteteve ekonomike me çmime aktuale 2004

Tabela 1c (i): Duke konsideruar UNMIK-un si rezident dhe merr pjesë në BPV

në milion Euro				
Aktivitetet ekonomike	Pjesëmarrja e BPV me çmimet prodhuese	Bruto vlera e shtuar	Konsumi i ndërmjetëm	Output
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	100,0%	2.472,5		
Bruto produkti vendor me çmimet baze	84,0%	2.075,7		
AKTIVITETET GJITHSEJ	84,0%	2.075,7	1.423,6	3.499,3
Bujqësia dhe peshkimi	7,1%	178,4	95,8	274,2
Minierat, prodhimi, rryma elektrike dhe uji	12,5%	313,1	287,3	600,4
Sherbimet	63,2%	1.584,3	1.040,5	2.624,7
Ndërtimtaria	9,9%	248,6	305,2	553,8
Tregtia me shumicë dhe pakicë	8,4%	211,5	93,6	305,1
Hotelet dhe restorantet	2,7%	68,1	51,2	119,3
Transporti dhe komunikacioni	3,9%	98,7	47,5	146,1
Ndërmjetësimi financiar	4,1%	102,5	45,7	148,2
Pasuria e patundshme dhe shërbimet e biznesit	15,6%	390,8	13,1	403,9
Administrata publike dhe mbrojtja	16,8%	421,2	384,8	806,1
Qeveria E Kosovës	4,9%	123,1	256,3	379,5
UNMIK	11,9%	298,1	128,5	426,6
Arsimi	0,4%	9,7	24,5	34,1
Shëndetësia dhe punët sociale	0,8%	19,6	52,7	72,4
Shërbimet komunale, sociale dhe personale	0,5%	13,7	22,0	35,7
Plus: Tatimet mbi produktet	16,0%	396,8		

Tabela 1c (ii): Duke mos konsideruar UNMIK-un si rezident

Aktivitete ekonomike	Pjesëmarrja e BPV me çmimet prodhuese	Bruto vlera e shtuar	në milion Euro	
			Konsumi i ndërmjetëm	Output
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	100,0%	2.174,4		
Bruto produkti vendor me çmimet baze	81,8%	1.777,6		
AKTIVITETET GJITHSEJ	81,8%	1.777,6	1.295,1	3.072,7
Bujqësia dhe peshkimi	7,1%	178,4	95,8	274,2
Minierat, prodhimi, rryma elektrike dhe uji	12,5%	313,1	287,3	600,4
Sherbimet	51,3%	1.286,2	912,0	2.198,1
Ndërtimtaria	9,9%	248,6	305,2	553,8
Tregtia me shumicë dhe pakicë	8,4%	211,5	93,6	305,1
Hotelet dhe restorantet	2,7%	68,1	51,2	119,3
Transporti dhe komunikacioni	3,9%	98,7	47,5	146,1
Ndërmjetësimi financiar	4,1%	102,5	45,7	148,2
Pasuria e patundshme dhe shërbimet e biznesit	15,6%	390,8	13,1	403,9
Administrata publike dhe mbrojtja	4,9%	123,1	256,3	379,5
Arsimi	0,4%	9,7	24,5	34,1
Shëndetësia dhe punët sociale	0,8%	19,6	52,7	72,4
Shërbimet komunale, sociale dhe personale	0,5%	13,7	22,0	35,7
Plus: Tatimet mbi produktet	18,2%	396,8		

Bruto produkti vendor në Kosovë sipas shpenzimeve me çmime aktuale 2002

Tabela 2a (i): Duke konsideruar UNMIK-un si rezident dhe merr pjesë në BPV

në milion Euro		
	Pjesëmarrja në BPV	Vlera
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	100%	2.590,0
Konsumi final	116%	3.008,0
Konsumi final i ekonomive shtepiake	77%	1.985,1
Konsumi final i Qeverisë	39%	1.023,0
Qeveria e Kosovës	15%	382,1
UNMIK	25%	640,9
Formimi i kapitalit bruto	24%	619,7
Formimi i bruto kapitalit fiks	23%	599,7
Ndryshimet neto ne inventar	1%	20,0
Neto eksporti i mallrave dhe shërbimeve	-40%	-1.037,7
Eksporti	6%	145,7
Eksporti i mallrave	2%	44,8
Eksporti i shërbimeve	4%	100,9
Importi	46%	1.183,4
Importi i mallrave, c.i.f.	36%	938,3
Importi i shërbimeve	9%	245,2

Tabela 2a (ii): Duke mos konsideruar UNMIK-un si rezident

	në milion Euro	
	Pjesëmarrja në BPV	Vlera
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	100%	2.139,3
Konsumi final	111%	2.367,1
Konsumi final i ekonomive shtëpiake	93%	1.985,1
Konsumi final i Qeverisë	18%	382,1
Formimi i kapitalit bruto	29%	619,7
Formimi i bruto kapitalit fiks	28%	599,7
Ndryshimet neto në inventar	1%	20,0
Neto eksporti i mallrave dhe shërbimeve	-40%	-847,5
Eksporti	16%	335,9
Eksporti i mallrave	4%	95,2
Eksporti i shërbimeve	11%	240,7
Importi	55%	1.183,4
Importi i mallrave, f.o.b.	44%	938,3
Importi i shërbimeve	11%	245,2

Bruto produkti vendor në Kosovë sipas shpenzimeve me çmime aktuale 2003

Tabela 2b (i): Duke konsideruar UNMIK-un si rezident dhe merr pjesë në BPV

	në milion Euro	
	Pjesëmarrja në BPV	Vlera
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	100%	2.505,0
Konsumi final	118%	2.947,1
Konsumi final i ekonomive shtepiake	79%	1.989,5
Konsumi final i Qeverisë	38%	957,7
Qeveria e Kosoves	18%	461,5
UNMIK	20%	496,2
Formimi i kapitalit bruto	25%	638,1
Formimi i bruto kapitalit fiks	25%	618,1
Ndryshimet neto ne inventar	1%	20,0
Neto eksporti i mallrave dhe sherbimeve	-43%	-1.080,2
Eksporti	6%	138,5
Eksporti i mallrave	2%	45,5
Eksporti i sherbimeve	4%	93,0
Importi	49%	1.218,7
Importi i mallrave, c.i.f.	39%	987,7
Importi i sherbimeve	9%	231,0

Tabela 2b (ii): Duke mos konsideruar UNMIK-un si rezident

	në milion Euro	
	Pjesëmarrja në BPV	Vlera
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	100%	2.157,4
Konsumi final	114%	2.450,9
Konsumi final i ekonomive shtëpiake	92%	1.989,5
Konsumi final i Qeverisë	21%	461,5
Formimi i kapitalit bruto	30%	638,1
Formimi i bruto kapitalit fiks	29%	618,1
Ndryshimet neto në inventar	1%	20,0
Neto eksporti i mallrave dhe shërbimeve	-43%	-931,6
Eksporti	13%	287,1
Eksporti i mallrave	4%	86,2
Eksporti i shërbimeve	9%	200,9
Importi	56%	1.218,7
Importi i mallrave, f.o.b.	46%	987,7
Importi i shërbimeve	11%	231,0

Bruto produkti vendor në Kosovë sipas shpenzimeve me çmime aktuale 2004

Tabela 2c (i): Duke konsideruar UNMIK-un si rezident dhe merr pjesë në BPV

(në milion Euro)		
	Pjesëmarrja në BPV	Vlera
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	100%	2.472,5
Konsumi final	117%	2.884,8
Konsumi final i ekonomive shtepiake	81%	2.001,7
Konsumi final i Qeverisë	36%	883,0
Qeveria e Kosoves	18%	456,4
UNMIK	17%	426,6
Formimi i kapitalit bruto	30%	744,2
Formimi i bruto kapitalit fiks	30%	744,2
Ndryshimet neto ne inventar	0%	0,0
Neto eksporti i mallrave dhe sherbimeve	-47%	-1.156,5
Eksporti	6%	159,8
Eksporti i mallrave	3%	62,2
Eksporti i sherbimeve	4%	97,6
Importi	53%	1.316,2
Importi i mallrave, c.i.f.	46%	1.141,1
Importi i sherbimeve	7%	175,2

Tabela 2c (ii): Duke mos konsideruar UNMIK-un si rezident

	(në milion Euro)	
	Pjesëmarrja në BPV	Vlera
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	100%	2.174,4
Konsumi final	113%	2.458,2
Konsumi final i ekonomive shtëpiake	92%	2.001,7
Konsumi final i Qeverisë	21%	456,4
Formimi i kapitalit bruto	34%	744,2
Formimi i bruto kapitalit fiks	34%	744,2
Ndryshimet neto në inventar	0%	0,0
Neto eksporti i mallrave dhe shërbimeve	-47%	-1.028,0
Eksporti	13%	288,3
Eksporti i mallrave	4%	97,5
Eksporti i shërbimeve	9%	190,7
Importi	61%	1.316,2
Importi i mallrave, f.o.b.	52%	1.141,1
Importi i shërbimeve	8%	175,2

Bruto produkti vendor në Kosovë sipas aktiviteteve ekonomike me çmime konstante 2002

Tabela 3a (i): Duke konsideruar UNMIK-un si rezident dhe merr pjesë në BPV

në milion Euro me çmime të vitit 2002			
Aktivitetet ekonomike	Bruto vlera e shtuar	Konsumi i ndërmjetëm	Output
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	2.589,9		
Bruto produkti vendor me çmimet baze	2.193,4		
AKTIVITETET GJITHSEJ	2.193,4	1.233,5	3.426,9
Bujqësia dhe peshkimi	188,0	57,0	245,0
Minierat, prodhimi, rryma elektrike dhe uji	359,2	204,2	563,5
Shërbimet	1.646,1	972,3	2.618,4
Ndërtimtaria	208,0	308,9	516,8
Tregtia me shumicë dhe pakicë	201,3	67,3	268,6
Hotelet dhe restaurantet	63,1	38,5	101,6
Transporti dhe komunikacioni	90,6	33,7	124,3
Ndërmjetësimi financiar	59,6	20,3	79,9
Pasuria e patundshme dhe shërbimet e biznesit	431,3	9,7	441,0
Administrata publike dhe mbrojtja	541,2	459,9	1.001,2
Qeveria E Kosovës	90,5	269,7	360,3
UNMIK	450,7	190,2	640,9
Arsimi	19,4	11,5	31,0
Shëndetësia dhe punët sociale	24,9	14,8	39,6
Shërbimet komunale, sociale dhe personale	6,7	7,8	14,4
Plus: Tatimet mbi importet	396,6		

Tabela 3a (ii): Duke mos konsideruar UNMIK-un si rezident

në milion Euro me çmime të vitit 2002

Aktivitetet ekonomike	Bruto vlera e shtuar	Konsumi i ndërmjetëm	Output
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	2.139,2		
Bruto produkti vendor me çmimet baze	1.742,7		
AKTIVITETET GJITHSEJ	1.742,7	1.043,3	2.786,0
Bujqësia dhe peshkimi	188,0	57,0	245,0
Minierat, prodhimi, rryma elektrike dhe uji	359,2	204,2	563,5
Shërbimet	1.195,4	782,1	1.977,5
Ndërtimtaria	208,0	308,9	516,8
Tregtia me shumicë dhe pakicë	201,3	67,3	268,6
Hotelet dhe restaurantet	63,1	38,5	101,6
Transporti dhe komunikacioni	90,6	33,7	124,3
Ndërmjetësimi financiar	59,6	20,3	79,9
Pasuria e patundshme dhe shërbimet e biznesit	431,3	9,7	441,0
Administrata publike dhe mbrojtja	90,5	269,7	360,3
Arsimi	19,4	11,5	31,0
Shëndetësia dhe punët sociale	24,9	14,8	39,6
Shërbimet komunale, sociale dhe personale	6,7	7,8	14,4
Plus: Tatimet mbi importet	396,6		

Bruto produkti vendor në Kosovë sipas aktiviteteve ekonomike me çmime konstante 2003

Tabela 3b (i): Duke konsideruar UNMIK-un si rezident dhe merr pjesë në BPV

në milion Euro me çmime të vitit 2002

Aktivitetet ekonomike	Norma e rritjes	Bruto vlera e shtuar	Konsumi i ndërmjetëm	Output
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	-5,9%	2.438,1		
Bruto produkti vendor me çmimet baze	-8,5%	2.007,9		
AKTIVITETET GJITHSEJ	-8,5%	2.007,9	1.396,0	3.403,9
Bujqësia dhe peshkimi	-5,6%	177,6	78,2	255,7
Minierat, prodhimi, rryma elektrike dhe uji	-14,7%	306,4	260,1	566,5
Shërbimet	-7,4%	1.523,9	1.057,8	2.581,7
Ndërtimtaria	3,0%	214,2	341,4	555,6
Tregtia me shumicë dhe pakicë	-6,1%	189,1	84,1	273,2
Hotelet dhe restaurantet	7,5%	67,9	48,5	116,4
Transporti dhe komunikacioni	-7,8%	83,5	41,0	124,6
Ndërmjetësimi financiar	30,5%	77,8	34,1	111,9
Pasuria e patundshme dhe shërbimet e biznesit	-7,2%	400,4	10,9	411,3
Administrata publike dhe mbrojtja	-19,0%	438,6	460,3	898,9
Qeveria E Kosovës	10,4%	100,0	311,6	411,6
UNMIK	-24,9%	338,7	148,7	487,4
Arsimi	8,8%	21,1	13,3	34,4
Shëndetësia dhe punët sociale	1,4%	25,2	15,1	40,3
Shërbimet komunale, sociale dhe personale	-7,7%	6,2	9,0	15,1
Plus: Tatimet mbi importet	8,5%	430,2		

Tabela 3b (ii): Duke mos konsideruar UNMIK-un si rezident

në milion Euro me çmime të vitit 2002

Aktivitetet ekonomike	Norma e rritjes	Bruto vlera e shtuar	Konsumi i ndërmjetëm	Output
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	-1,9%	2.099,5		
Bruto produkti vendor me çmimet baze	-4,2%	1.669,2		
AKTIVITETET GJITHSEJ	-4,2%	1.669,2	1.247,3	2.916,5
Bujqësia dhe peshkimi	-5,6%	177,6	78,2	255,7
Minierat, prodhimi, rryma elektrike dhe uji	-14,7%	306,4	260,1	566,5
Shërbimet	-0,8%	1.185,3	909,1	2.094,3
Ndërtimtaria	3,0%	214,2	341,4	555,6
Tregtia me shumicë dhe pakicë	-6,1%	189,1	84,1	273,2
Hotelet dhe restaurantet	7,5%	67,9	48,5	116,4
Transporti dhe komunikacioni	-7,8%	83,5	41,0	124,6
Ndërmjetësimi financiar	30,5%	77,8	34,1	111,9
Pasuria e patundshme dhe shërbimet e biznesit	-7,2%	400,4	10,9	411,3
Administrata publike dhe mbrojtja	10,4%	100,0	311,6	411,6
Arsimi	8,8%	21,1	13,3	34,4
Shëndetësia dhe punët sociale	1,4%	25,2	15,1	40,3
Shërbimet komunale, sociale dhe personale	-7,7%	6,2	9,0	15,1
Plus: Tatimet mbi importet	8,5%	430,2		

Bruto produkti vendor në Kosovë sipas aktiviteteve ekonomike me çmime konstante 2004

Tabela 3c (i): Duke konsideruar UNMIK-un si rezident dhe merr pjesë në BPV

në milion Euro me çmime të vitit 2002				
Aktivitetet ekonomike	Norma e rritjes	Bruto vlera e shtuar	Kosnumi i ndërmjetëm	Output
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	-0,9%	2.415,0		
Bruto produkti vendor me çmimet baze	0,9%	2.025,3		
AKTIVITETET GJITHSEJ	0,9%	2.025,3	1.419,8	3.445,0
Bujqësia dhe peshkimi	-3,1%	172,0	95,8	267,8
Minierat, prodhimi, rryma elektrike dhe uji	-2,6%	298,3	290,9	589,2
Shërbimet	2,0%	1.555,0	1.033,1	2.588,1
Ndërtimtaria	12,0%	240,0	304,0	543,9
Tregtia me shumicë dhe pakicë	9,3%	206,7	92,9	299,7
Hotelet dhe restaurantet	1,1%	68,6	51,4	120,0
Transporti dhe komunikacioni	15,4%	96,4	47,1	143,5
Ndërmjetësimi financiar	30,5%	101,5	45,4	146,9
Pasuria e patundshme dhe shërbimet e biznesit	-1,7%	393,4	13,0	406,4
Administrata publike dhe mbrojtja	-6,3%	410,9	380,8	791,7
Qeveria E Kosovës	19,1%	119,1	253,7	372,7
UNMIK	-13,8%	291,9	127,2	419,0
Arsimi	-67,4%	6,9	24,2	31,1
Shëndetësia dhe punët sociale	-30,6%	17,5	52,2	69,7
Shërbimet komunale, sociale dhe personale	114,0%	13,2	21,9	35,1
Plus: Tatimet mbi importet	-9,4%	389,7		

Tabela 3c (ii): Duke mos konsideruar UNMIK-un si rezident

në milion Euro me çmime të vitit 2002

Aktivitetet ekonomike	Norma e rritjes	Bruto vlera e shtuar	Konsumi i ndërmjetëm	Output
Bruto produkti vendor me çmimet e tregut	1,1%	2.123,2		
Bruto produkti vendor me çmimet baze	3,8%	1.733,4		
AKTIVITETET GJITHSEJ	3,8%	1.733,4	1.292,6	3.026,0
Bujqësia dhe peshkimi	-3,1%	172,0	95,8	267,8
Minierat, prodhimi, rryma elektrike dhe uji	-2,6%	298,3	290,9	589,2
Shërbimet	6,6%	1.263,2	905,9	2.169,1
Ndërtimtaria	12,0%	240,0	304,0	543,9
Tregtia me shumicë dhe pakicë	9,3%	206,7	92,9	299,7
Hotelet dhe restaurantet	1,1%	68,6	51,4	120,0
Transporti dhe komunikacioni	15,4%	96,4	47,1	143,5
Ndërmjetësimi financiar	30,5%	101,5	45,4	146,9
Pasuria e patundshme dhe shërbimet e biznesit	-1,7%	393,4	13,0	406,4
Administrata publike dhe mbrojtja	19,1%	119,1	253,7	372,7
Arsimi	-67,4%	6,9	24,2	31,1
Shëndetësia dhe punët sociale	-30,6%	17,5	52,2	69,7
Shërbimet komunale, sociale dhe personale	114,0%	13,2	21,9	35,1
Plus: Tatimet mbi importet	-9,4%	389,7		

Enti Statistikës së Kosovës (ESK) – përshkrim i shkurtër

Enti i Statistikës si Ent profesional vepron që nga viti 1948, dhe ka kaluar nëpër të gjitha fazat historike të Kosovës. Me 2 Gusht të vitit 1999 Enti ka rifilluar punën e tij si i pavarur dhe si Institut profesional i administratës publike profesionale. Buxheti i konsoliduar i Kosovës dhe donatorët e ndryshëm për projekte të veçanta e financojnë Entin.

Rregullorja për Statistika (Rregullorja 2001/14) ka hyrë në fuqi me 2 Korrik 2001. ESK është një agjencion ekzekutiv i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike (MSHP). Një Master Plan (plan zhvillimor afatmesëm) për sistemin statistikor është në zhvillim e sipër.

Struktura organizative: Shtatë Zyra Rajonale (Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe Mitrovicë, dhe Qendra Kryesore në Prishtinë) për momentin kanë gjithsej 137 të punësuar, 90 të punësuar në QK dhe 47 të punësuar në Zyrat Rajonale. Është 1 Këshilltar Afatgjatë nga Statistikat e Suedisë, financuar nga Sida dhe 1 kordinatore e Projekteve të Statistikave të Suedisë, ESK. Enti i Statistikës së Kosovës ka një teren krejtësisht të mbuluar për organizimin e anketave me regjistruar me përvojë dhe mundësi të mjaftueshme të transportit. Një ekip i ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar janë duke punuar në projektin e regjistrimit të popullsisë.

Misioni i Entit është që t'i përmbushë nevojat e përdoruesve për të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare dhe t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa:** Enti i Statistikës së Kosovës, Rr."Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë
- **Telefonat:**
Qendra kryesore: +381 (0) 38 235 111
Drejtori: +381 (0) 38 235 545 ose +381 (0) 38 504 604 lok. 6572
- **Fax:** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** economic@ks-gov.net
- **Web-faqe:** www.ks-gov.net/esk